



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

Numri i lëndës: 2024:073191

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05770106

PPP.nr.04/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të përmbarimit, sipas propozimit për përmbarim të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, kundër debitorit të përmbarimit K.Th nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, lidhur me përmbarimin e dokumentit përmbarues aktvendimit të Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.4514, i datës 03.12.2018, i formës së prerë nga data 15.04.2019, ndërsa i ekzekutueshme nga data 01.05.2019, i lejuar me urdhërin për përmbarim P.nr.814/20, i datës 23.10.2020, të përmbaruesit privat I.Sh në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarimit, më datë 03.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbarimit K.Th nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.814/20, i datës 23.10.2020, të përmbaruesit privat I.Sh në Prishtinë.

II. MBETET NË FUQI urdhri i përmbaruesit privat I.Sh në Prishtinë P.nr.814/20, i datës 23.10.2020, me të cilin është caktuar përmbarimi në bazë të dokumentit përmbarimor aktvendimit të Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.4514, i datës 03.12.2018, i formës së prerë nga data 15.04.2019, ndërsa i ekzekutueshme nga data 01.05.2019, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 25,115.41 euro, në emër të gjobës administrative, me kamatë ligjore 8 %, nga dita e paraqitjes së propozimit me datë 23.10.2020 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarimor..

**A r s y e t i m**

Organi i përbarimit, përbaruesi privat I.Sh në Prishtinë, ka caktuar përbarimin sipas Urdhërit për përbarim P.nr.814/20, i datës 23.10.2020, në bazë të dokumentit përbarimor aktvendimit të Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.4514, i datës 03.12.2018, i formës së prerë nga data 15.04.2019, ndërsa i ekzekutueshme nga data 01.05.2019, kundër debitorit K.Th nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 25,115.41 euro, në emër të gjobës administrative, të caktuar sipas aktvendimit të lartpërmendur të kësaj gjykate.

Kundër urdhrit me të cilin është caktuar përbarimi, debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kontestuar urdhërin për lejimin e përbarimit, me pretendime se urdhëri përbarimor është në kundërshtim me të drejtën material dhe procedural, në kuptim të faktit se kreditori ka tendencë të ngarkimit të borxhit në mënyrë të pa bazuar. Përveç, kësaj i njëjti pretendon se veprimi i kreditorit është qartësisht është i kundërligjshëm, arbitrar dhe në kundërshtim me institutet procedurale dhe materiale, ashtu që në këto rrethana e bëjnë të paqëndrueshëm urdhërim përbarimor. I njëjti ka theksuar se urdhëri përbarimor P.nr.814/20, i datës 23.10.2020, sipas të cilit është caktuar pagesa e borxhit është në vendosje pranë Gjykatës Supreme, si dhe epilogu i të njëjtës ende nuk është përfundimtar sa i përket qëndrimeve juridike, përgjegjësisë dhe ligjshmërisë. Gjykatës i propozoi që ta aprovoj prapësimin, si dhe ta shfuqizoj urdhërin për lejimin e përbarimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 15.02.2024, duke cekur se i kundërshton pretendimet e debitorëve në tërësi si të pabazuara. I njëjti ka shtuar se prapësimi i debitorit nuk përmbana kurrfarë arsytimi të bazuar në fakte dhe prova të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së. Ndërsa pretendimi i debitorit se tërësia e këtij procesi është në kundërshtim me të drejtën materiale dhe procedurale për faktin se debitori nuk ka qenë duke ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm, ky pretendim është i pabazuar për fakti se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhëri përbarimor parqet titull ekzekutiv. Lidhur me këtë çështje debitori ka paraqitur ankesë në Komisionin e Ankesave, të KPMM-së, si organ i shkallës së dytë dhe pas shqyrtimit ankesa është refuzuar në bazë të aktvendimit të Komisionit të Ankesave të KPMM-së. Andaj akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm duke pasur parasysh faktin se debitori nuk e ka kryer pagesën e cekur sipas afatit të paraparë. Pretendimi i debitorit se çështja është në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, andaj ky vendim duhet të pezullohet, edhe ky pretendim është i pabazuar, sepse bazuar në nenin 22 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ, kundër të cilit është paraqitur, përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e përbarimor i kanë kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditorës, urdhërit për caktimin e përbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës ka ardh në përfundim se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar.

Gjykata me analizimin e propozimit për përbarim P.nr.814/2020 të datës 23.10.2020, Aktvendimit Nr.4514, i datës 03.12.2018 i dhënë në procedurën administrative nga KPMM-ja,

ka ardh në përfundim se debitori në bazë të këtij aktvendimit ndaj kreditores ka krijuar borxh shumë prej 22,115.41 €uro, i njëjti ka marrë formën e prerë me datë 15.04.2019, ndërsa është bërë i ekzekutueshëm nga data 01.05.2019 dhe se i përmbushë të gjitha kushtet ligjore konform LPP-së nenit 22 par.1 nënpar.1.2, nenit 23 par.2 dhe nenit 24 par.3 në të cilët përcaktohet se (neni 22 par.1 nënpar.1.2) *”Dokumente përmbaruese janë: 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative... ”*, neni 23 par.2 *” Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike”* dhe neni 24 par. 3 *”Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*.

Sipas LPP-së nenit 27 par.1 përcaktohet se *”Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga kjo rezulton se vendimi në fjalë është titull përmbarimor për shkak se e ka të përcaktuar kreditorin dhe debitorin, kohën e përmbushjes së detyrimit, dhe shumën e përmbushjes. Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi që ta refuzoj prapësimin e debitorit, pasi që pretendimi i tij se veprimi i kreditorit është qartësisht është i kundërligjshëm, arbitrar dhe në kundërshtim me institutet procedurale dhe materiale gjykata i vlerëson si pretendime të pabazuara, pasi që këto pretendime debitori ka mundur që ti kontestoj në procedurë administrative duke e kontestuar aktin administrativ. Gjykata, gjithmonë duke u bazuar në parimet e të drejtës më saktësisht në parimin e rigorozitetit formal në procedurën përmbarimore nuk ka tagër që të lëshohet në ligjshmërinë materiale të dokumentit përmbarues, në bazë të të cilit kërkohet përmbarimi. Po ashtu, pretendimet e debitorit se urdhri përmbarimor P.nr.814/20, i datës 23.10.2020, sipas të cilit është caktuar pagesa e borxhit është në vendosje pranë Gjykatës Supreme, si dhe epilogu i të njëjtës ende nuk është përfundimtar sa i përket qëndrimeve juridike, përgjegjësisë dhe ligjshmërisë, gjykata i vlerëson si pretendime të pabazuara, si dhe ky fakt nuk paraqet pengesë që i njëjti të përmbarohet. Gjykata në procedurën përmbarimore kujdeset se a është bërë propozimi për përmbarim dhe a është lejuar përmbarimi në bazë të dokumentit përmbarues siç kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi. Në procedurën përmbarimore organi përmbarues e cakton dhe zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumenteve të besueshme dhe dokumenteve përmbarues, siç është Aktvendimi Nr.4514, i datës 03.12.2018, i plotfuqishëm nga data 15.04.2019, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 01.05.2019, sipas të cilit edhe është iniciuar kjo procedurë përmbarimore.

Gjykata vendosi lidhur me kamatën ligjore si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 382 të LMD-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës së përmbarimit, në këtë çështje juridike të përmbarimit, kjo gjykatë e mori në kuptim të nenit 13 të LPP-së lidhur me nenin 452 par.1 të LPK-së, pasi që secila palë duhet t'i bartë paraprakisht harxhimet të cilat i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të

përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarimor.

Nga ajo që u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 nënpar.1.1, neni 23 par.1, 24 par.1, neni 27 par.1, neni 71,73 nenit 77 par.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenit 382 par.1 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
PPP.nr.04/2024, me datë 03.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.